

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SHËRBIMIN E SHIKËSIAVE (KKS) (KKS) (KKS)
 IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

REPUBLIKA SHQIPË KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 20			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01 -	060/08	5	1831

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 09.11.2023

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 5

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

☐

Numri i anëtarëve të KKS-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 15

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKS-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☒

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKS-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☒

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 03.08.2023

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf>

2. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore në Komunën e Drenasit;
3. Tetori- Muaji i Ndërgjegjësimit kundër kancerit të Gjirit
4. Fushata vetëdijësuese në Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
5. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e radhës me 26 Tetor në sallën e Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 15 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit, drejtorë të drejtorive komunale. Mbledhja u udhëheq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala.

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 03.08.2023:* <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf>. Pika e parë u aprovua në mënyrë unanime, pa ndonjë vërejtje.
2. *Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore në Komunën e Drenasit;* Lidhur me këtë pikë, Shefi i Njesisë së Zjarrfikësve të Drenasit, z. Afrim Gjeli theksoi shqetësimin e zjarreve fushore gjatë muajve të fundit. Ai tregoi se nga Janari deri në Tetor kanë qenë gjithsej 457 raste, prej tyre 398 zjarre, duke apeluar të të gjithë akterët që të ndikojnë në zvogëlimin e këtyre rasteve

të cilat shumicën e herave shkaktohen nga faktori njeri, qoftë me qëllim apo pa qëllim. Ai kërkoi mobilizim nga të gjithë në mënyrë që kjo gjendje të ndryshohet në të ardhmen pasi edhe këtë vit numri i zjarreve fushore ka qenë i lartë.

3. *Tetori- Muaji i Ndërgjegjësimit kundër kancerit të Gjirit*; Lidhur me këtë pikë, shefja e sektorit të Shëndetësisë znj. Lumturie Kiqina njoftoi të pranishmit me aktivitetet që kanë organizuar si fushatë vetëdijuese me gra të Drenasit nën moton “Një hap kundër Kancerit të Gjirit”. Gjithashtu, ajo njoftoi se QKMF-ja ka mamografin falas ku të gjitha gratë mund të kontrollohen falas dhe të bëjnë zbulimin e hershëm të kësaj sëmundje. Te kjo pikë, përfaqësuesja e KVRL, Donika Zogu informoi anëtarët bashkë me të rinjtë kanë shpërndarë material me qëllim ndërgjegjësimi në luftën kundër kancerit të gjirit dhe kërkoi nga drejtoritë bashkëpunim që kur të kenë fushata të tilla të informojnë edhe KVRL pasi janë të gatshëm të bashkëngjiten dhe të kontribuojnë.
4. *Fushata vetëdijuese në Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore*; Lidhur me këtë pikë anëtarët u njoftuan për fushatën kundër trafikimit që po zhvillohet nga Zyra për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryetarit, përkatësisht për organizimin e aktiviteteve nëpër shkolla, si shtypja e fletpalosjeve, posterëve etj. Këto material me qëllim sensibilizimit kundër trafikimit janë shpërndarë nëpër shkolla fillore në Komunën e Drenasit.

5. *Të ndryshme*

Tek të ndryshmet ndër disa tema që u ngritën për diskutim mungesa e materialeve shkollore të disa nxënës, temë që u ngritë nga Arben Haziri nga Këshilli i Prindërve, dhe nënkryetari Shala theksoi se kjo çështje është ngritur vazhdimisht si shqetësim edhe i komunës dhe që të njëjtën e kanë adresuar në Ministrinë përkatëse. U diskutua gjithashtu mungesa e ujit në fshatin Krajkovë, përkatësisht funksionalizimit të ujësjellësit në këtë fshat, ku drejtori i Ujësjellësit për komunën e Drenasit z. Ismet Baliu theksoi se ai rezervari ka nevojë për intervenim në mënyrë që të merret në menaxhim dhe të

funksionalizohet. Ndërsa, nënkryetari z.Shala theksoi se po ri-izolohet para se t'i dorëzohet ujësjellësit në menaxhim.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:

Izveštaj prapremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime / potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 09.11.2023

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mph.dsh@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.